



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 20-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 27.06. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
2. Avni Olluri, drejtor i DA
3. Shkelzen, Hajdini, drejtor i DEZH

4. Rasim Hasani, drejtor i DKA
5. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
6. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
7. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
8. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
9. Imer Rustemi, drejtor i DI,
10. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
11. Vlora Limani-Hajnuni DSHMS
12. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
12. Vlora Krasniqi, zyrtare ligjore
13. Besart Troshupa, zyra e informimit
14. Bekim Krasniqi, OJQ "YAGR"
15. Kimete Jashanica, OSBE
16. Kastriot JahaJ, OSBE
17. Bestar Ibrahim,
18. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Rrahim Krasniqi**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 30 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 19-të e Kuvendit.
2. Propozim vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore(KAB)2020-2022
3. Propozim vendim për miratimin e planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme
4. Propozim vendim për miratimin e Planit të veprimit rinor lokal(2019-2021)Lipjan
5. Propozim Rregullore për ndarjen e subvencioneve
6. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për rregullimin e komunikacionit rrugor në disa rrugë të qytetit të Lipjanit 15Nr.345-28060 te datës 02.05.2018.
7. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Politike dhe Financa.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se me kërkesë të ekzekutivit është që pika e 3-të e rendit të ditës propozim vendim për miratimin e planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme të shtyhet për një seancë tjetër për shkak të disa gabimeve teknike.

Lulzim Rustemi, kam një propozim që pika e 7-të e rendit të ditës propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Politike dhe Financa të shtyhet për një seancë tjetër.

Ukë Kryeziu, unë do t'i respektoj të gjitha procedurat ligjore dhe atë çka vendos Kuvendi, unë më nuk do të jem anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe do të jem vetëm anëtar i Kuvendit. Por kisha dhënë një propozim që të riformulohen komitetet tjera.

Meqë vërejtje nuk pati rreth rendit të ditës, Kryesuesi tha se me kërkesën për heqjen e pikes së 3-të nga rendi i ditës po e vëj në votim dhe pas votimit konstatoi se 24 vota për, 6 kundër kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, kam për t'i ngritur disa çështje; e para ka të bëjë me ekipin e patronazhit e cila nuk ekziston në QKMF në Lipjan dhe qytetarët po përballen me probleme të shumta ku kanë raste të ndryshme në familjet e tyre. E di që është dhënë një arsyetim nga drejtorati për shëndetësi se kjo është mungesë për shkak të një veture por unë mendoj që kjo punë mund të bëhet edhe pa të. Çështja tjetër ka të bëjë në DKA ku javën e kaluar është mbajtur testi i maturës dhe ajo çka më ka ra në sy janë drejtorët e shkollave të cilët kanë marrë pjesë për shkak të meditive prej 50€, ndërsa shkollën e tyre e kanë lënë bosh. Çështja e tretë ka të bëjë me volumin e naltë të muzikës në shesh. Çështja e fundit ka të bëjë me kontinjerët e mbeturinave ku po hudhen mbeturinat në veqanti nga bizneset jo në kontinjer por afër tyre.

Arben Salihu, edhe unë deshta ta ngris çështjen e zhurmës në shesh por së fundi një qytetarit pas një ankese të bërë në ekzekutiv i është kthyer përgjigjja se kujt i pengon zhurma në qytet letë shkoj të jetoj në fshat.

Ganimete Qeriqi, edhe unë pajtohem me Albulenen rreth ekipës së patronazhit ku unë çdo ditë ballafaqohem me probleme të tilla nga qytetarët dhe këtë çështje e kam ngritur edhe më herët disa kolegë dhe kjo ka hasur në vesh të shurdhët dhe këtu nuk po i konvenon dikujt që të ketë një ekip të patronazhit.

Nehat Tërpeza, deshta me ngrit një çështje rreth DKA-së ku në kohën e fundit janë nxënë 10 kg drogë nëpër shkolla dhe deshta me pyetur drejtorin e arsimit a keni një plan për këtë çështje për vitin e ri akademik 2019-2020, po ashtu kemi dëgjuar që kohën e fundit ka braktisje të mësimit nëpër shkolla a jeni në dijeni për këtë çështje dhe a keni listë të nxënësve të cilët kanë braktisur shkollën. Po ashtu rruga Ribar i Madh-Poturovc është mbulu nga shkurret kisha kerku që të largohen ato shkurre për shkak se po janë pengesë e madhe për këmbësorët që po kalojnë aty pari.

Bashkim Budakova, kam një kërkesë gjegjësisht shqetësim të të rinjëve sportdashës të komunës së Lipjanit ku kërkesa e tyre është se nuk mund t'i shfrytëzojnë hapsirat sportive të hapura për shkak të ndriçimit publik i cili nuk është funksional afër fushës së hapur "Beeter life".

Lulzim Rrustemi, kam për t'i ngritur një shqetësim dhe një kërkesë: në Komitetin për Komunitete, komunitetit serb ka ngritur një shqetësim për mos fitimin e një granti nga ana e një organizate jo qeveritare dhe kanë shtruar pyetje cila ka qenë arsyeja që ne se kemi fituar grantin deshta me pyet se a keni obligim me i njoftu edhe ata të cilët nuk e kanë fituar grantet. Po më intereson lista e 12 organizatave që kanë fitua grante a është shqyrtu, a keni pasur ndonjë ankesë deri ku ka shku procedura. E dyta kam një shqetësim rreth planit të punës së Kuvendit ku DKA-ja ende nuk na ka dhënë ndonjë informatë rreth arsimit, rreth prokurimit, rreth komiteteve jo funksionale, të bujqësisë etj. Dhe kërkoj që ta zbatoni planin e punës së Kuvendit.

Daut Azemi, në përgjithësi agjenda e planit të punës është tu shku ashtu siç e kemi parapa.

Lulzim Rrustemi, unë nuk pajtohem me ty pasi që prej 5 planifikimeve veq një është realizu, ndërsa sa i përket një informate total të menaxhimit të pronave ju asnjëherë nuk e keni pru.

Daut Azemi, keni parasysh që pikat e Kuvendit i cakton ekzekutivi në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit.

Argjend Tasholli, kam një pyetje për drejtoratin e shërbimeve publike për rrugën Vrellë - Gadime ku rruga është dëmtuar nga vërshimet dhe është mbuluar me gjethe dhe kërkoj që të pastrohet.

Hyra Bytyçi, kam një pyetje për DKA-në lidhur me një marrëveshje në mes të tyre dhe Ministrisë së arsimit për ngritjen e cilësisë së arsimit në SHMP "Adem Gllavica", a do të ketë trajnime edhe për nxënësit apo vetëm për mësimmshënësit.

Ramiz Qeriqi, kam një shqetësim për nxënësit e shkollës fillore në Grackë të Vjetër kur do të kanë të drejtë ata të hyjnë në shkollë, apo kur do t'i ndërtojmë një shkollë ku 60 nxënësia i bartim prej atyhit i qojmë në shkollë, ndërsa në atë shkollë janë vetëm 6 nxënës të komunitetit, deshta me pyet se a menaxhojna na në atë shkollë. Pyetja tjetër ka të bëjë për drejtorin e inspektionit ku e pyes se a shkon ndonjëherë me i vizitu lokalet kah Kisha ku ato firmen e tyre e kanë me shkronja çirilice po du me ditë se a menaxhohen ato nga ana juaj.

Fehmi Rexhepi, deshta të ngris shqetësimin e banorëve të fshatit Medvec rreth mungesës së ujit të pijshëm ku ky fshat nuk po merret parasysh rreth kësaj çështje ku unë vet kam pasur takime edhe me drejtorët e ujësjellësit dhe nuk po u bëhet zgjidhje këtyre banorëve. Po ashtu kam një kërkesë për renovimin e shkollës së Medvecit.

Fatime Krasniqi, kam një pyetje për DKA-në lidhur me librat e shkollës që po na kthehen nga nxënësit po nxinet një klasë dhe nuk po kemi të drejtë t'i dërgojmë diku tjetër çka duhet të veprojmë në këtë rast pasi që ato letra janë të pa shfrytëzueshme.

Albulena Kelmendi, kërkoj të marrë përgjigjen rreth ekipës së patronazhit por deshta të ngris një shqetësim rreth problemit të ujit të pijshëm ku drejtori i ujësjellësit pat thënë se në mars do të përmirësohet por si duket nuk është bërë asgjë për këtë çështje madje kjo po vërehet edhe nepër fshatra dhe unë kërkoj nga ekzekutivi që të ndërmarrin masa.

Rasim Hasani, komisioni i testit të maturës është përgjegjësi e DKA-së dhe është bërë me kërkesën e ministrisë së arsimit dhe është përgjegjësi e imja me i zgjedh njerëzit më të përgjegjshëm. Sa i përket dukurisë së drogës nëpër shkolla institucionet përgjegjëse janë duke u mundu me pengu këtë dukuri. Në raport të Kryetarit e keni pas edhe raportin e DKA-së ku janë të cekura informatat edhe rreth braktisjes së nxënësve nëpër shkolla. Secila shkollë e ka nga një komision për ndalimin e braktisjes së shkollave. Kemi marrëveshjen e parë me GIZ-in në lëminë e arsimit për shkollën profesionale. Nxënësve të Grackës ne ju kemi siguru transportin pasi që deri dje e kanë paguar vet. Sa i përket shkollës së Medvecit edhe aty në të ardhmen do të intervenohet, ndërsa sa i përket librave të vjetra ato nxënësit i kthejnë në shkolla dhe ne e dijmë që librat për nxënës i jep ministria e arsimit dhe ato janë të ministrisë dhe unë disa herë i kam bërë kërkesë ministrisë së arsimit për me ardhë me i marrë ato libra por ata nuk kanë kthyer kurrfarë përgjegje.

Vlora Limani-Hajnuni, sa i përket ekipit të patronazhit teritorit të komunës së Lipjanit është kogjo i gjërë dhe ne kemi vetëm dy auto ambulanca dhe ne nuk guxojmë me lënë emergjencën pa auto ambulancë. Momentin që do të vijë auto ambulanca ekipi i patronazhit do të jetë gati i funksionalizuar kah fundi i korrikut dhe ne i kemi vetëm dy ambulanca njëra duhet të jetë në oborin e emërgjencës, ndërsa tjetra duhet të jetë në teren gjatë lojërave sportive.

Imer Rustemi, zhurma një problem shqetësues për qytetarët por ne kemi parapa plan dinamik për këtë çështje dhe për këtë çështje inspektoriat i është kompetent vetëm deri në ora 22,⁰⁰ ndërsa pas orës 22,⁰⁰ përgjegjës është policia. Sa i përket hudhjes së mbeturinave afër kontinjerëve kemi raste që i kemi gjobitur por kem edhe disa raste që vijnë nga fshatrat dhe po i hudhin mbeturinat në qytet por inspektoriat i është në teren. Sa i përket bizneseve në Lipjan afër Kishës ato janë në mbikqyrjen tonë dhe kemi pasur raste kur edhe i kemi sanksionuar.

Bekim Shabani, sa i përket pyetjes për OJQ-të ka qenë thirrje publike dhe Kryetari i Komunës e ka caktuar një komision dhe komisioni ka vendosur dhe të gjitha OJQ-të njoftohen ose përmes emailit zyrtar ose përmes njoftimit në web faqe.

Ilir Tasholli, sa i përket ndriçimit në kompleksin sportiv do të rregullohet kah fundi i javës. Sa i përket rrugës Poturovc – Ribar ne kemi kontaktuar me një kompani dhe së shpejti do të filloj pastrimi i saj. Sa i përket rrugës Vrellë-Gadime po edhe fshatra tjera për rreth edhe ai projekt do të përfundoj shumë shpejt. Sa i përket ujësjellësit as na nuk jemi të kënaqur por që pajtoheni ju dhe Kryesuesi mund ta ftoni të raportoj në Kuvend drejtorin e ujësjellësit.

Albulena Kelmendi, në mungesë të argumenteve nganjëherë drejtorët dinë edhe mos me u përgjegjë.

Ganimete Qeriqi, sa i përket ekipës së patronazhit me të vërtetë është gjendja keq dhe duhet sa më shpejt të rregullohet se çdo minut për pacientët është shumë.

Ukë Kryeziu, sa i përket ekipit të patronazhit e tha edhe drejtoresha që aty së pari duhet të ketë staf shtesë, po ashtu të ketë edhe mekanizëm dhe shpresojmë që do të funksionalizohet kah muaji gusht ashtu siç e tha drejtoresha. Por të thuhet që nuk ka ekage në emërgjencë spo muj me kuptu kur dihet që ka. Kemi pas donacione nga Zvicra nga Feti Gërbeshi edhe ekage edhe mjete

tjera. Punët që po bëhen nuk mund t'i mohojmë por e kisha lutur edhe drejtoreshen që ta informojnë drejtë të gjithë menaxherët se ku është defekti.

Vlora Limani-Hajnuni, unë edhe në seancën e kaluar e kam përmend që ekipi i paztronazhit do të funksionalizohet vetëm po presim veturën ta marrim. Depilatori nuk ka qenë funksional për qytetarët, ka qenë në paket të cilin nuk kemi mundur ta shfrytëzojmë. Në asnjë qendër të mjekësisë familjare nuk kemi ekage, po ashtu nuk ke banjo për me i kry analizat por brenda dy viteve ato do të rregullohen.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 19-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 19-të dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, 1 apstenim

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 19-të e Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore(KAB)2020-2022

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, ne si grup parlamentar e mbështesim këtë propozim vendim por kemi disa pyetje. Te investimet kapitale kisha kërku që ato projekte të cilat po bëhen të mbikëqyren më mirë. Për shembull te rruga Vrellë - Gadime, rruga me emrin "Gjakova" është rregulluar para 3-4 viteve por tani janë ndarë apert mjete për rregullimin e asaj rruge për shkak të cilësisë së dobët. Po ashtu buxheti i ndar për shëndetësi është i ulët dhe duhet të ndahet buxhet më i madh në vitet në vazhdim, Po ashtu as arsimit nuk qëndron më mirë e që duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi dhe një pyetje për fund çka përfshijnë subvencionet dhe transferet në vlerë prej 100 mijë euro që janë i ndarë zyrës së Kryetarit.

Afrim Miftari, edhe ne si grup parlamentar e mbështesim për faktin se është në bazë të një skeme që rritë zhvillimin ekonomik ku sipas kësaj parashihet që dikun 4.6% të ketë rritje. E veçant e këtij buxheti është se shumica e projekteve kanë marrë emrin e që ishte kërkesë e qytetarëve. Kjo është bërë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi dhe në bazë të degjimeve buxhetore dhe ne si të tillë e mbështesim.

Lulzim Rrustemi, kjo kornizë sipas grupit parlamentar të PDK-së i ka disa defekte dhe është dashtë të shtjellohet më mirë. Kam një pyetje për drejtorin përveq rritjes së pagave a janë përfshi edhe pagat jubilarë të cilat po janë problem për punonjësit e ndryshëm dhe sektorët e ndryshëm. Ne zakonisht po bëjmë buxhet atëhok, buxhet që po kërkojnë qytetarët por nuk po fokusohemi në strategjin zhvillimore të nivelit komunal. Buxheti është koncentru prap në asfalte por nuk kemi asnjë projekt për ujë të pijshëm, ndërsa për ambient kemi vetëm një projekt. Ku për 4 vite janë 104 projekte 35 prej tyre asfale 14 trotuare, kur dihet që na kemi nevojë për

projekte tjera siç është arsimi ku cilësia është e dobët, shëndetësia dobët, ambienti dobët. E keni parapa edhe projektin e sheshit për vitin 2022 por ne ende nuk e kemi pa atë projekt nuk e dimë se kush e ka bërë çka parashihet në të. Keni parapa me u shtrur rrugë nëpër fshatra por nuk e keni cekë se cila rrugë do të asfaltohet. Ky projekt ka vend për përmirësim dhe është larg standardeve dhe ne si PDK kërkojmë më shumë investim në arsim, shëndetësi, bujqësi. Kam një pyetje për drejtorin të investimet kapitale për vitin 2019 me krahasu me vitin 2020 në këtë vit 2020 keni zvogëlim e ku do të ishte e kundërta.

Hyra Bytyçi, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë kornizë afatëmesme buxhetore e cila bazohet në Ligjin për menaxhimin e financave publike. Mundësia për rishikim ka afat deri në shtator. Vlenë të theksohet se janë marrë parasysh edhe dëgjimet publike buxhetore dhe kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Vlenë të theksohet se janë marrë parasysh edhe kërkesat e neve anëtarëve të Kuvendit të cilët kemi marrë pjesë në dëgjimet buxhetore e të cilat janë qerdhet në fshatin Gadime dhe Sllovi dhe bursat për student.

Ukë Kryeziu, unë do të ndalem te investimet kapitale në fshatin Sllovi ku kemi një kod buxhetor për vazhdimin e trotuarit në shumë prej 68 mijë euro, ndërsa për qerdhe në Sllovi nuk është e planifikume në vitin 2020 por në vitin 2021 dhe kërkojmë që të përfshihet në vitin 2020. Shqetësuese për fshatin Sllovi është uji i pijshëm ku kam kërkuar edhe në seancat e kaluara që të futet zgjerimi i kapaciteteve të ujit të pishëm. Sllovia numron mbi 4 mijë banorë dhe gjysma e tyre nuk kanë ujë të pijshëm. Unë e di që për menaxhim është përgjegjëse kompania e ujësjellësit por për zgjerimin e kapaciteteve të ujit përgjegjësia kalon te ju. Kërkoj nga ana e juaj që mundësisht të përfshihet zgjerimi i kapaciteteve të ujit për fshatin Sllovi. Po ashtu kërkoj edhe përfundimin e rrugës Sllovi-Dobratin i cili qe sa kohë ka mbet pa u rregulluar ku në këtë rrugë mungojnë edhe shenjëzimi i rrugës qoftë horizontal apo vertikal. Kërkoj nga ana e juaj që të rifillojnë punimet në atë rrugë.

Lumturije-Bytyqi-Hasani, në dëgjimet publike që i kemi mbajtur me komitetet obligative unë i kam shtruar disa kërkesa, ndërtimi i qerdheve në 4 fshatrat më të mëdha në Gadime, Sllovi, Shalë dhe Magurë, renovimi i stamatologjisë, bursa për student përmes subvencioneve, po më vjen mirë që kërkesat e mia janë marrë parasysh, për kundër faktit që qerdhja në Shalë nuk është parapa por është mirë që edhe kjo me u përfshi.

Bashkim Budakova, kam një kërkesë të banorëve të fshatit Rubovc i Madh që në këtë kornizë buxhetore të përfshihet rruga "Elbasani" që e lidh shkollën e re me rrugën kryesore, ndërsa sa i përket investimeve për fshatin Rubovc i Madh, Rubovc i Vogël dhe Kojskë nuk ka menduar drejtë ku ndriçimi publik dhe trotuari janë parapa në vitin 2022, kërkoj që të merret parasysh kjo kërkesë dhe të shqyrtohet.

Nazmi Krasniqi, kam me i ngrit dy pyetje e para ndërtimi i shkollës në Lipjan kam dëshirë me ditë se ku do të jetë lokacioni dhe e dyta a janë parapa mjetet për punonjësit arsimor të cilët pensionohen dhe është mirë që kjo të parashihet.

Albulena Kelmendi, në dëgjimet publike që kemi mbajtur në komitetet obligative në mesin e kërkesave që i kemi bërë njëra prej tyre është përfshirja e pagesës së ushqimit për nxënësit e cikleve të ulëta nëpër shkolla e kjo nuk është përfshi po shpresojmë që në kornizat e ardhshme do të përfshihet.

Lulzim Rustemi, kisha kërku që më shumë të ketë investime në kulturë dhe gjatë ndërtimit të qendrave kulturore është mirë që të përfshihen edhe bibliotekat.

Latif Ramadani, sa i përket subvencioneve te zyra e Kryetarit ato janë shku aty për shkak se me to përfshihen shpenzimet e varrimit. Sa i përket pagave jubilarë na çdo herë e parashikojna pasi që është një udhëzim administrativ të cilin e ka caktuar ministria. Sa i përket ujit të pijshëm ka investime edhe nga CDI-ja po edhe komuna por edhe ne si qytetarë nuk po i bëjmë pagesat sa duhet. Qerdhet i kemi planifikuar për vitin 2020. Sa i përket ndërtimit të shkollës në Lipjan ne i kemi nda mjetet, ndërsa për lokacionin do të vendosim së bashku me Kuvendin. Ndërsa sa i përket shujtave për nxënësit nuk kemi pasur ndonjë kërkesë të tillë nga drejtorët e shkollave.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 22 për, 3 kundër, 4 apstenime, aprovoi këtë:

VENDIM
MBI APROVIMIN E KORNIZES AFATMESME BUXHETORE 2020-2022

Neni 1.

Me këtë Vendim aprohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2020-2022 për Komunën e Lipjanit

Neni 2.

Me , Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022
Grant i Përgjithshëm	6,156,012.00	6,496,608.00	6,884,382.00
Grant Specifik i Arsimit	7,494,228.00	7,531,699.00	7,569,357.00
Grant Specifik i Shëndetësis	2,104,564.00	2,188,746.00	2,276,296.00
Të hyrat vetanake	2,080,919.00	2,154,214.00	2,227,862.00
Financimi Shërbimet Rezedenciale	170,000.00	170,000.00	170,000.00
TOTALI	18,005,723.00	18,541,267.00	19,127,897.00

Neni 3.

Mjetet nga neni 2.i këtij Vendimi do shpërdahen ne kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022
Paga e Mëditje	10,908,653.00	10,908,653.00	10,908,653.00
Mallra dhe Shërbime	1,526,070.00	1,636,070.00	1,686,070.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	266,000.00	266,000.00	266,000.00
Subvencione dhe Transfere	377,000.00	437,000.00	462,000.00
Investimet Kapitale	4,928,000.00	5,293,544.00	5,805,174.00
TOTALI	18,005,723.00	18,541,267.00	19,127,897.00

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi pas publikimit në Web faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve.

Neni 6.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

III

Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për rregullimin e komunikacionit rrugor në disa rrugë të qytetit të Lipjanit 15Nr.345-28060 te datës 02.05.2018.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Ilir Tashollit, drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Anila Reçica, duke e parë kaosin në rrugët e Lipjanit një vendim i tillë në këtë kohë është i mirëseardhur dhe Komuna e Lipjanit po dëshmon gadishmërinë të ndryshoj situatën në vendim të duhur dhe ne e përkrahim këtë propozim vendim.

Arben Salihu, kam një kërkesë që rruga që kalon ka Kisha deri te marketi, parkingu që është në anën e majtë që kish pas mundësi me u bartë në anën e trotuarit.

Afrim Miftari, ne edhe në KPF e kemi diskut këtë çështje por nuk e di a po mbetet koha që e diskutum në KPF prej 10,⁰⁰ deri 22,⁰⁰ apo kjo që është në vendim, për ndryshe ne e përkrahim.

Nazmi Krasniqi, unë mendoj që bizneset nuk duhet të pengohen por duhet të ju mundësohet që të punojnë dhe më shumë veturat e parkuara po e pengojnë rrugën e bizneseve duhet të ju lihet hapsir të punojnë.

Albulena Kelmendi, zhvillimi i bizneseve nuk duhet të pengohet sepse kjo i pengon edhe qytetarët edhe komunën në përgjithësi dhe orari deri 11 nuk po më duket që i pengon ato biznese, dhe si të tillë ne do ta përkrahim këtë propozim vendim.

Lulzim Rustemi, nuk e di a janë bërë analizat e Bollëshme me bizneset dhe ky po më duket diskriminim me qitë për tre muaj dhe pastaj me e hiq prap dhe mendoj që duhet me i dalë në ndihmë biznesit por edhe policia duhet të angazhohen më shumë dhe kjo deri në ora 11,⁰⁰ duhet me vle.

Ilir Tasholli, kemi bërë një analizë shumë të mirë kësaj çështje dhe me shtimin e fluksit të automjeteve po bllokohen rrugët e Lipjanit. Nuk është pengim i biznesit nëse nuk e lejojmë një veturë me u ndal para kafiterisë më shumë se 3 minuta kur dihet se Lipjani i ka 1000 parkingje publike. Sa i përket pyetjes së Arbenit për bartjen në pjesën tjetër të rrugës do të bisedojmë me ekspert dhe nëse është e nevojshme do të vijmë me një propozim në seancat e ardhshme.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 30 vota për, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR RREGULLIMIN E KOMUNIKACIONIT RRUGOR NË DISA RRUGË TË QYTETIT TË LIPJANIT 15Nr.345-28060 TË DATËS 02.05.2018

Neni 1

Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet neni 2 pika 9 e Vendimit për rregullimin e komunikacionit rrugor në disa rrugë të qytetit të Lipjanit 15nr.345-28060 të datës 02.05.2018 dhe riformulohet si vijon:

9. Rruga “Avdi Kelmendi” përcaktohet rrugë me ndalim parkimi në të katër shiritat e rrugës ndërsa rrugët “Lidhja e Prizrenit”, dhe “Komandant Kumanova” përcaktohen rrugë me ndalim ndaljeje dhe parkimi në të katër shiritat e rrugës përveç furnizuesve me mall të bizneseve ku u lejohet ndalja prej orës 23:⁰⁰ në mbrëmje deri në ora 11:⁰⁰ të ditës vijuese .

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Inspektorat i Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Drejtorati për Shërbime Publike në rrugët e lartëcekura do të vendosë tabelën përkatëse .

Ky plotësim ndryshim vlenë deri më datën 01.09.2019, pas kësaj date ky plotësim ndryshim shfuqizohet.

Shtesë: Vendimi.

Pastaj Kryesuesi dha pauzë prej orës 12,⁰⁰ deri në ora 13,⁴⁰

IV

Propozim vendim për miratimin e Planit të veprimit rinor lokal(2019-2021)Lipjan

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Bekim Shabanit, drejtor i DRSK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, është një plan i mirë i detajizuar por në një punëtori të organizuar nga OSBE është kritikuar ky plan pasi që nuk është e kënaqshme pjesëmarrja në debat e të rinjëve për të cilët po bëhet ky plan. Kam një pyetje për drejtorin se a është marrë për bazë debati i të rinjëve në këtë çështje pasi që ata kanë kritikuar që nuk kanë marrë pjesë. Nëse dikujt i duhet ky plan ky i duhet rinisë dhe duhet t'i marrim rekomandimet e tyre dhe duhet t'i mbështesim. Po ashtu është debatuar që këshilli i veprimit rinor lokal nuk është funksional.

Arben Salihu, kisha propozu që te pika 5.5 të hiqet radikalizmi fetar pasi që ka edhe radikalizmi jo fetar dhe të mbetet vetëm radikalizëm.

Safete Amerllahu, unë shprehu kënaqësin time që Komuna e Lipjanit ka bërë një plan strategjik, të rinjtë janë njerëzit më me vlerë dhe unë ata i shoh si pjesëmarrës më të mirë në Komunën e Lipjanit dhe shpresojmë që ky plan të jetë dinamik dhe të zbatohet në periudhën e ardhshme për të cilën parashihet.

Bekim Shabani, sa i përket këtij plani ka pasur punëtori edhe më herët dhe është debatuar por jo gjithmonë e gjithë rinia mund të jenë të kënaqur. Për ndryshimin e pikës 5.5 nëse vendos Kuvendi unë pajtohem.

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 28 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL (2019-2021) LIPJAN

Neni 1

MIRATOHET, Plani i Veprimit Rinor Lokal (2019-2021) në Komunën e Lipjanit

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i Veprimit Rinor Lokal (2019-2021) Lipjan.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë:Vendimi.

V

Propozim Rregullore për ndarjen e subvencioneve

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit, drejtor i DRSK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, unë mendoj që është më mirë me shtu një paragraf për bursa për student. Te paragrafi 2 me u shtu edhe një paragraf me vazhdu me paragrafin 3, ky është propozimi im me u shtu edhe një paragraf për bursa për student.

Albulena Kelmendi, në këtë Rregullore kemi pasur një problem ku te neni 4 e kemi edhe me njoftim publik edhe pa njoftim publik. Unë mendoj që në të gjitha rastet duhet të bëhet njoftim publik me përjashtim te ndonjë rasti urgjent ose botimi të ndonjë libri dhe mendoj që konkurse publike duhet të ketë çdo herë me përjashtim të rasteve të pa parashikuara.

Daut Azemi, dha sçarim se te pika 2 parashtuesi e kërkesave për subvencionim në fushën e arsimit duke përjashtuar pikën 1.1 ku ndarja e bursave për student do të realizohet sipas kriterëve të përcaktuara me konkurs publik.

Nazmi Krasniqi, bursat për student me sa e di unë janë 4 vjeçar, nuk është bërë një analizë detale nga drejtorati dhe ekzekutivi pasi që këtu nuk profilizohet se çka na nevojitet kur e dimë se kemi shumë baçellora e mastera dhe është dashtë me pas kriterë specifike pasi që kemi 400-500 student në Lipjan.

Daut Azemi, bursat do të ndahen në bazë të konkursit publik, neve disa vite nuk na është leju me nda bursa nga ministria por nëse na lejohet me nda na po e trasojmë rrugën për me nda bursa nëse na lejon ministria.

Nehat Tërpeza, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim Rregullore me ndryshimet që i dha drejtori më herët.

Arben Salihu, kam kërku edhe më herët që të subvencionohen gratë e pa puna në rastin e lindjes apo nënat amvise siç i kam quajtur, nëse kish pas mundësi që të përfshihen në kuadër të Rregullores.

Bekim Shabani, unë kërkoj që kjo Rregullore të mbështetet me ndryshimet që i propozova e për ndryshime tjera presim të na vijnë propozimet në formë të shkruar e pastaj do të shohim si do të vendosim.

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 30 votat për, aprovoi këtë:

VI

Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Politike dhe Financa

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se mua më ka ardhur një kërkesë nga partia (AAK) për zëvendësimin e anëtarit të KPF-së Ukë Kryeziu, pasi që ai ka kalu në radhët e PDK-së. Unë kam kërkuar interpretim ligjor për këtë çështje nga ministria dhe ata e kanë kthyer një përgjigje të cilën e keni edhe ju, unë e kam prurë në Kuvend dhe është e juaja se si do të vendosni.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ganimete Qeriqi, unë mendoj që duhet të zbatohen dispozitat ligjore.

Lumturije Bytyqi-Hasani, mendoj që përgjigjja e MAPL-së është gjysmake dhe është mirë që kjo pikë me u shty dhe me kërku interpretim edhe njëherë nga ministria për pyetjen e dytë, e jo me pas përfaqësim njejtë si një subjekt politik që i ka 7 anëtarë me një subjekt politik që i ka dy anëtarë.

Nazmi Krasniqi, Uka më herët tha se unë më nuk do të jem pjesë e KPF-së.

Ukë Kryeziu, unë do t'i respektoj të gjitha procedurat ligjore, gadishmëria ime është që më nuk do të jem pjesë e KPF-së.

Afrim Miftari, pres një sçarim çka nëse Kuvendi vendos që mos me kalu ky vendim a do të mbetet Uka apo ai vend do të jetë i zbrazët.

Daut Azemi, Kryesuesi i Kuvendit, nëse vendos Kuvendi Uka do të jetë prap anëtarë i KPF-së, por nëse e bjen kërkesën për zëvendësim në KPF, unë prap do të procedoj.

Lulzim Rrustemi, ne jemi për me u shty deri në formulimin e komiteteve.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e grupit të PDK-së që kjo pikë të shtyhet dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 6 votat për, 22 kundër ky propozim nuk kaloi.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit e hodhi në votim propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Politike dhe Financa dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se 7 vota për, dhe 19 apstenime, nuk kaloi ky propozim vendim.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 14,⁴⁰

Ekstraktin e hartoi
Rrahim Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi